

# PIKA E VESËS

në terminologjinë e hadithit



SHKROI:  
FLORIAN LEI



بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

## Parathënie

I madhëruar qoftë ndriçuesi i qiejve dhe i tokës me nurin e imanit, udhëzuesi i zemrave me dritën e Kuranit. Paqe dhe bekime pastë pishtari i udhëzimit dhe zotëria i njerëzimit, profeti ynë Muhamedi dhe të afërmit e tij ehlibejti. Rizaja e zotit qoftë për shokët e tij dhe për këdo që pason rrugën e tyre për sa kohë që Allahu madhërohet dhe emri i tij lartësohet.

Shkenca e hadithit është një nga shkencat me të cilën muslimanët u dalluan nga popujt e tjerë. Ajo ishte faktori kryesor që kontriboi për ruajtjen e pastër të fesë, brez pas brezi. Umeti i Muhamedit ishte umeti që meritoi përgëzimet më të shumta nga krijuesi i gjithësisë. Nga këto përgëzime ishte përmbushja e mirësisë me përsosjen e fesë së tyre dhe ndoshta ky përgëzim do të mbetej në hije sikur të mos pasohej nga një tjetër përgëzim akoma më madhështor, që ishte premtimi për ruajtjen e islamit deri në frymën e fundit të kësaj bote.

Në anën tjetër, përderisa nga urtësia e pafund e krijuesit ishte krijimi i shkaqeve dhe i pasojave për çdo gjë që lundron në gjithësi, ishte mëse e natyrshme që përmbushja e këtij premtimi të realizohej nëpërmjet shkaqeve përkatëse, të cilat në fund të fundit kthehen te caktimi dhe përkujdesja e vetë krijuesit. Ishin pikërisht dijetarët dhe studiuesit e hadithit ata që mbajtën mbi supë këtë barrë të rëndë, duke e merituar plotësisht epitetin “trashgimtarë të pejgamberit”, si trashgimtarë të dijes dhe të udhëzimit profetik.

Ky punim është një paraqitje e shkurtër e disa termave elementare të shkencës së hadithit. Problematika e terminologjisë është një problematikë tepër e gjerë dhe delikate. Trajtimi i termave të një shkence apo të një disipline si fjalë artistike dhe gjuhësore shpeshherë çon në gabime fatale dhe keqkuptim të koncepteve kyçe të asaj disipline. Ky konstatim bëhet më i prekshëm në shkencën e hadithit, e cila është një shkencë karakteristike e këtij umeti dhe terminologjia e saj nuk para has terma sinonime në gjuhët e tjera. Nëse në lëmin e studimeve gramatikore dhe juridike kemi deri diku terma dhe koncepte të njëjta dhe të përafërta, në terminologjinë e hadithit është shumë e vështirë të jepem terma ekuivalentë që ruajnë ekzaktësisht origjinalitetin e nocioneve dhe të koncepte që shprehin.

Ishte ky shkaku kryesor nga ku morri shtysë ky punim i shkurtër, me objektiv kryesor paraqitjen e disa termave që qarkullojnë shpesh në fjalorin e studiuesve të hadithit, si hap i parë për përfytyrimin sa më të drejtë të çështjeve fetare. Punimi është fokusuar në çështje dhe terma elementare duke iu shmangur zgjerimeve dhe kundërshtimeve të papërshtatëshme për nivelin fillestar. Ai është vetëm një përpjekje modeste për sqarimin e disa principeve bazë të kësaj shkence pa e futur lexuesin në labirinthe dhe thella të saj.

E lus Allahun ta bëjë të dobishëm dhe frytdhënës dhe të na mbulojë me mëshirën e tij mua bashkë me lexuesin dhe falenderimi i takon Allahut, zotit të gjithësisë.

Shkroi: Florian Leli

Hartum, 20.5.2016

# *Pika e vesës*

## *në terminologjinë e hadithit*

- 1 *Me emrin e zotit shtohen begatitë* ❀❀❀ *me dhikrin e tij përmbushen mirësitë*
- 2 *Salati dhe selami qofshin pa nda* ❀❀❀ *për zotërinë tonë hazretin mustafa*
- 3 *Për shokët e tij dhe për ehli bejtin* ❀❀❀ *dhe çdo musliman që pason sunetin*
- 4 *Dije se hadithi ndahet në dy pjesë* ❀❀❀ *metën dhe sened që janë shtyllë e fesë*
- 5 *Senedi hadithit një zinxhir formon* ❀❀❀ *me burrat e tij te metni të çon*
- 6 *Teksti i hadithit me fjalët e tjera* ❀❀❀ *është metni që lexon e gjithë njerëzia*
- 7 *Në bazë rivajetesh ndahet në dy gradë* ❀❀❀ *hadithe mutevatir të tjera ahad*
- 8 *Tevatur kemi me aq shumë transmetime* ❀❀❀ *sa është e pamundur që të ketë trukime*
- 9 *Gradën e tevaturit ahdi s'e mbërrin* ❀❀❀ *tre lloje të tij mbizotrojnë në din*
- 10 *Azizi përcillet të paktën nga dy vetë* ❀❀❀ *meshhurit i shtohet edhe një i tretë*
- 11 *Hadithi garib në një shtresë vetmohet* ❀❀❀ *një burrë i vetëm nga të tjerë veçohet*
- 12 *Pranimi i ahadit apo refuzimi* ❀❀❀ *kthehet te dija dhe te hulumtimi*
- 13 *Hadithi sahih ai është i pranuar* ❀❀❀ *në të të pesë kushtet janë plotësuar*
- 14 *Përcillet prej dabitit përvetësues* ❀❀❀ *i drejtë në fenë e tij çdo transmetues*
- 15 *I lidhur pa shkëputje gjer në fund* ❀❀❀ *shudhudi apo ilet nuk ka askund*
- 16 *I thënë më shkurt thikat pas thikati* ❀❀❀ *i pastër nga shudhudi dhe ilati*
- 17 *Haseni çfarë na vjen në transmetim* ❀❀❀ *prej burrit të mangët në përvetësim*
- 18 *Çdo kusht haseni sa herë rrëzohet* ❀❀❀ *i dobët daif ky hadith gjykohet*
- 19 *Në rrugë të shumta nëse na përçohet* ❀❀❀ *në rang haseni edhe mund të ngrihet*

- 20 Një tjetër ndarje në hadith bazohet \*\*\* në vartësi se kujt i adresohet
- 21 Merfu thirret hadithi që përfundon \*\*\* në fjalë dhe vepra te profeti jonë
- 22 Sa herë te sahabi senedi ndalon \*\*\* me termin meukuf ti e emërton
- 23 Quaj mektu çdo vepër a shprehje \*\*\* te një tabiin nëse gjen prehje
- 24 Senedi muttesil-it ngjan si gjerdan \*\*\* i lidhur shejh për shejh vjen si vargan
- 25 Merfu-i muttesil i lidhur në sened \*\*\* sipas xhumhurit njihet për musned
- 26 Fjalët e profetit që tabini sjell \*\*\* ai s'i ka dëgjuar prandaj janë mursel
- 27 Shkëputja munkatiut kuptohet fare lehtë \*\*\* pasi mes dy vetëve mungon një i tretë
- 28 Fshehje të shejhut bën mudel-lisi \*\*\* me "prej" apo "nga" që është tedlisi
- 29 Mes dy thikatëve kur ka kundërshtim \*\*\* deri aty sa s'mund të ketë pajtim
- 30 Mahfudhi më i fortë ka përparësi \*\*\* shadhi kundërshtues tregon dobësi
- 31 Lëkundjet mospajtuese janë idtirab \*\*\* hadithi me përplasje quhet mudterib
- 32 Daifi e thikati kur bien ndesh \*\*\* marufin e të dytit merre parasysh
- 33 Munkerin daifit kurrë mos ja prano \*\*\* gabimin e tij patjetër refuzo
- 34 Hadithi meudu çfarë është trilluar \*\*\* nga një gënjeshtar ai është sajuar
- 35 Për tadil vlerësohet çdo kompliment \*\*\* në adresë të ravit e bën një kompetent
- 36 Thikati i besueshëm në transmetim \*\*\* saduku më pak por vlen për pranim
- 37 Ravin e rrëzon xherhi i shtjelluar \*\*\* cenet ja shfaq kritika e qëlluar
- 38 Bazuar te fisku bidati sajesa \*\*\* gabimi gafleti si dhe ngatërresa
- 39 Mexhhuulu ajni kush është nuk njihet \*\*\* mexhhuulu halit gjëndja nuk i dihet
- 40 Zotit tim bujar në fund i kërktoj \*\*\* në rrugën e tij të na udhëzojë
- 41 me hamdin e tij po e përfundoj \*\*\* me pikën e vesës po e titulloj


## Koncepte bazë rreth hadithit

- 1 *Me emrin e zotit shtohen begatitë* ❀❀❀ *me dhikrin e tij përmbushen mirësitë*
- 2 *Salati dhe selami qofshin pa nda* ❀❀❀ *për zotërinë tonë hazretin mustafa*
- 3 *Për shokët e tij dhe për ehli bejtin* ❀❀❀ *dhe çdo musliman që pason sunetin*
- 4 *Dije se hadithi ndahet në dy pjesë* ❀❀❀ *metën dhe sened që janë shtyllë e fesë*
- 5 *Senedi hadithit një zinxhir formon* ❀❀❀ *me burrat e tij te metni të çon*
- 6 *Teksti i hadithit me fjalët e tij* ❀❀❀ *është metni që lexon e gjithë njerëzia*

Çdo hadith përbëhet nga dy pjesë kryesore, metni dhe senedi. Senedi është zinxhiri i transmetuesve të hadithit, i lidhur apo i shkëputur qoftë, që të çon tek metni i hadithit.

Metni është teksti i hadithit, pavarësisht çfarë tregon, fjalë vepra apo aprovime dhe pavarësisht se kujt i adresohet: profetit, sahabiut apo kujtdo tjetër.

Për ilustrim po sjellim hadithin që e transmeton imam Buhariu në Sahihun e tij:



Senedi apo isnadi, është quajtur kështu sepse fjala *sened* në aspektin leksikor tregon mbështetje tek diçka, si mbështetje e diçkaje në mur. A thua se transmetuesi e mbështet fjalën e tij tek pararendësi i tij dhe ky i dyti tek një i tretë e gjer sa fjala t'i adresohet thënësit.

Senedi është një karakteristikë dalluese e umetit islam. Nëpërmjet tij është ruajtur feja e pastër ashtu siç ka zbritur. Shqyrtimi i senedit ka një zanafillë të herët në umet. Tabini i shquar Muhamed ibn Sirini *\_Allahu e mëshiroftë\_* ka thënë: “*Nuk pyesnin për isnadin, por kur ndodhi fitneja zunë të thonë: na i tregoni burrat (transmetuesit) tuaj dhe nëse vërehej të ishin prej pasuesve të sunetit e pranonin hadithin e tyre dhe nëse vëreheshin të ishin prej pasuesve të bidatit nuk e pranohej hadithin e tyre*”.<sup>1</sup>

Sufjan Theuriu *\_Allahu e mëshiroftë\_* ka thënë: “*Isnadi është arma e besimtarit. Nëse nuk posedon armë me çfarë lufton atëherë!*”.<sup>2</sup>

Abdullah ibn Mubareku *\_Allahu e mëshiroftë\_* ka thënë: “*Sipas meje isnadi është prej fesë. Sikur të mos ishte isnadi do të fliste kushido çfarë të dëshironte*”.<sup>3</sup>



---

<sup>1</sup> Parathënia e Sahihut të imam Muslimit.

<sup>2</sup> E përmend Ibn Hibani në “El mexhruhin”.

<sup>3</sup> Parathënia e Sahihut të imam Muslimit.

## **Ndarja e hadithit në bazë të numrit të rrugëve të transmetimit.**

### **7 Në bazë rivajetesh ndahet në dy gradë ❀❀❀ hadithe mutevatir të tjera ahad**

Rivajeti është transmetimi apo rruqa e transmetimit. Rivajetet dhe rrugët e hadithit variojnë në numër dhe në sasi. Disa hadithe transmetohen vetëm nga një rrugë e vetme dhe në disa hadithe numri i rrugëve të transmetimit është tepër i madh. Sipas numrit të rivajeteve hadithi ndahet në dy lloje:

- 1- hadith mutevatir.
- 2- hadith ahad.

### **8 Tevatur ka me aq shumë transmetime ❀❀❀ sa është e pamundur që të ketë trukime**

Hadithi **mutevatir** është hadithi që transmetohet nga një numër i shumë transmetuesish në çdo shtresë (tabaka) të senedit, të cilët zakonisht është e pamundur të bien në ujdë për trillim apo trukim të tij.

Ka mendime të ndryshme për numrin e rrugëve apo të rivajeteve që hadithi të arrijë cakun e tevaturit. Ibn Haxheri Allahu e mëshiroftë thotë:

*“Shumësia (e rrugëve) është një nga kushtet e tevaturit, nëse transmetohet me një numër të palimitizuar dhe zakonisht është e pamundur që ata të bien në ujdë për të gënjyer apo që gënjeshtër të ndodhë spontanisht. Prandaj nuk ka kuptim që të përkufizohet me një numër të caktuar (rrugësh) sipas mendimit të saktë”<sup>4</sup>.*

Kushtëzohet që numri të jetë i shumë nga shtresat fillestare të transmetimit e deri te shtresat e larta që i përkasin sahabëve dhe të mos pakësohet, përndryshe nuk konsiderohet mutevatir.

Kushtëzohet gjithashtu që metni i tij të shprehë diçka të vrojtueshme apo të dëgjueshme dhe jo thjesht një çështje logjike. Pra transmetuesi në fund të hadithit të thotë: kam parë apo kam dëgjuar.

Hadithi mutevatir ndahet në dy nënkategori:

---

<sup>4</sup> Nuz'hatun nadhar, botim i shtëpisë botuese “El mathur”, tahkik dhe komente të Tarik Ivad, fq: 49.



### 1) Mutevatir tekstual

Ai është hadithi mutevartir, rrugët e transmetimit të të cilit janë pajtuar rreth një teksti hadithi shprehimisht, pra fjalë për fjalë. Me shpjegimin e mësipërm kishim për qëllim pikërisht këtë lloj mutevatiri. Termi **mutevatir**, kur përdoret i pakufizuar tregon pikërisht këtë lloj mutevatiri.

Hadithi **mutevatir** është i rrallë dhe nuk haset shpesh, aq sa disa dijetarë e kanë mohuar ekzistencën e tij. Të tjerë e pranojnë ekzistencën e tij bashkë me faktin se ai është shumë i rrallë. Ebu Amr Ibn Salahu *Allahu e mëshiroftë* thotë:

*“Hadithi “Kush gënjen ndaj meje me qëllim, le ta zejë vendin e tij në zjarr” vlen si shëmbull për këtë (hadithin mutevatir). Këtë hadith e transmetojnë një numër i madh sahabësh Allahu qoftë i kënaqur prej tyre. Ky hadith transmetohet në dy sahihet nga një numër sahabësh.*

*Hafizi i madh Ebu Bekr Bezariu, në librin e tij të Musnedit përmend se këtë hadith e kanë transmetuar nga i dërguari i Allahut ﷺ afërsisht dyzet burra prej sahabëve. Disa hafizë përmendin se atë e kanë transmetuar gjatëdhjetë e dy sahabë, përfshi këtu dhjetë të përgëzuarit me xhenet.*

*Thotë (Bezariu): Përveç këtij hadithi, s’ka në dynja asnjë hadith tjetër për transmetimin e të cilit janë pajtuar dhjetë të përgëzuarit me xhenet. Gjithashtu nuk njihet ndonjë hadith tjetër i transmetuar prej gjatëdhjetë sahabëve nga i dërguari i Allahut ﷺ.*

*Them (Ibn Salahu): Disa dijetarë hadithi e kanë çuar numrin e transmetuesve të këtij hadithi më shumë se kaq. Për ta konsideruar këtë hadith për mutevatir mjafton edhe një numër më i vogël. Më tej numri i transmetuesve sa vjen e rritet vazhdimësisht dhe Allahu është më i ditur”.<sup>6</sup>*

### 2) Mutevatiri kuptimor.

Janë ato hadithe të cilat pajtohen rreth një kuptimi dhe teme të caktuar. Këto hadithe të marra veç e veç nuk e arrijnë gradën e tevaturit. Si shëmbull mund të merret çështja e ngritjes së duarve gjatë duasë. Janë transmetuar me dhjetra hadithe në situata dhe raste të ndryshme, në të cilat dëshmohet ngritja e duarve gjatë duasë. Hadithet që flasin për ngritjen e duarve, të marra veç e veç nuk e arrijnë gradën e tevaturit. Megjithatë ato janë pajtuar në këtë pikë të përbashkët, që është ngritja e duarve dhe për shkak të numrit të shumë të rrugëve themi se ky kuptim (ngritja e duarve) ka arritur gradën e tevaturit kuptimor.

### 9 Gradën e tevaturit ahad s’e mbërrin ❀❀❀ tre lloje të tij mbizotrojnë në din

Hadithi ahad përkufizohet si hadithi që nuk e arrin gradën e tevaturit. Rrugët e tij të transmetimit janë të kufizuara dhe jo aq të shumta sa të arrijë gradën e tevaturit. Hadithi ahad, në dallim me hadithin mutevatir, është shumë i përhapur dhe mbizotëron në hadithet e transmetuara.

---

<sup>5</sup> Ka për qëllim brezat e tjerë të transmetuesve të këtij hadithi, prej tabinëve dhe tabitabinëve.

<sup>6</sup> Mukadimeja e Ibn Salahun (Parathënia e Ibn Salahun), fq: 269.

Ai ndahet në tre lloje: meshhur, aziz dhe garib, të cilat do të sqarohen në vijim.

- 10 *Azizi përcillet të paktën nga dy vetë* ❁❁❁ *meshhurit i shtohet edhe një i tretë*
- 11 *Hadithi garib në një shtresë vetmohet* ❁❁❁ *një burrë i vetëm nga të tjerë veçohet*


### 1) Hadithi meshhur.

Hadithi *meshhur* është hadithi që transmetohet nga të paktën tre vetë në çdo brez apo shtresë të senedit. Origjina e emërimit kthehet tek fjala *shubra* që tregon njohjen dhe shquarjen e diçkaje, pasi për shkak të rrugëve të shumta të tij ai është bërë i njohur dhe i shquar në mesin e njerëzve.

Shëmbull për hadithin meshhur është fjala e profetit ﷺ: **Musliman është ai që muslimanët shpëtojnë prej gjuhës dhe dorës së tij**.

Ky është kuptimi i termit *meshhur* në terminologjinë e hadithit. Shpeshherë kjo fjalë përdoret në kuptimin gjuhësor të saj dhe kihen për qëllim hadithet që janë të njohura në fjalorin e një grupi të caktuar njerëzish, pavarësisht se ato mund të transmetohen vetëm nga një apo dy rrugë transmetimi, madje ndonjëherë mund të mos kenë sened fare, si shumë hadithe të njohura dhe të përhapura tek njerëzit. Në këtë kontekst kemi hadithe meshhure, pra të përhapura, në mesin e fukahave, usulistëve, gjuhëtarëve, etj.

*Musliman është ai që muslimanët shpëtojnë prej gjuhës dhe dorës së tij*



## 2) Hadithi aziz.

Hadithi aziz është hadithi që e përcjellin të paktën dy transmetues në të gjitha brezat e senedit.


Është quajtur kështu sepse tema *iz'ab*, nga ku rrejd kjo fjalë, merr kuptimin e forcës dhe të fuqisë, sepse hadithi i transmetuar nga dy rrugë transmetimi përforcohet, ose merr kuptimin e rrallimit, sepse ai është i rrallë dhe nuk haset shpesh.

Ibn Haxheri \_Allahu e mëshiroftë\_ e ilustron hadithin aziz me fjalën e profetit ﷺ: **“Askush prej jush nuk beson gjersa të jem më i dashur për të sesa prindi i tij dhe fëmija e tij dhe e gjithë njerëzia”.**

*Askush prej jush nuk beson gjersa të jem më i dashur për të sesa prindi i tij dhe fëmija e tij dhe e gjithë njerëzia*



Metni i hadithit



## 3) Hadithi garib


Përkufizimi i hadithit garib: Hadithi në të cilin veçohet një transmetues i vetëm qoftë edhe në një shtresë (brez) prej shtresave të senedit.

Është emërtuar me këtë term sepse fjala *garib* në gjuhën arabe tregon për të vetmuarin që jeton në vetmi, pa njerëz dhe të afërm.

Shëmbull për këtë hadith është hadithi me të cilin imam Buhariu hap Sahihun e tij nga Umer ibn Hatabi se i dërguari i Allahut ka thënë: **“Punët janë sipas njetit dhe çdo njeriu i takon ajo që ka synuar, prandaj kush ka emigruar për të arritur një plaçkë dynjaje apo për t’u martuar me një grua hixhreti i tij është për atë gjë për të cilën ka emigruar”.**

*Punët janë sipas njetit dhe çdo njeriu i takon ajo që ka synuar, prandaj kush ka emigruar për të arritur një plaçkë dynjaje apo për t'u martuar me një grua bixhreti i tij është për atë gjë për të cilën ka emigruar .*

← Metni i hadithit



**12 Pranimi i ahadit apo refuzimi ❀❀❀ kthehet te dija dhe te hulumtimi**

Objekt kryesor i studimit në shkencën e hadithit është pikërisht hadithi ahad. Dijetarët e hadithit përpiqen që nëpërmjet studimit të senedit dhe të metnit të arrijnë në seleksionimin e haditheve ahad në të pranuarra dhe të refuzuara.

Hadithi mutevatir nuk ka nevojë për shqyrtime të shumta, sepse siguria që ai paraqet është shumë e lartë dhe kategorike. Në kundërshtim me të, hadithi ahad ka nevojë për shqyrtime dhe hulumtime të gjera në lidhje me transmetuesit, rivajetet, përputhjet dhe përplasjet mes tyre, lidhjen dhe shkëputjen e senedit, etj, për të arritur më pas tek vlerësimi përfundimtar në lidhje me pranimin apo refuzimin e tij.



## **Ndarja e hadithit në bazë të pranimit dhe të refuzimit**

Hadithi i pranuar përfaqësohet nga dy degë kryesore që janë sahihu dhe haseni. Hadithi i refuzuar është hadithi daif i cili shfaq një larshmëri kategorish dhe ndarjesh.

### **13 Hadithi sahih ai është i pranuar ❀❀❀ në të të pesë kushtet janë plotësuar**

Në aspektin gjuhësor me fjalën *sahib* përshkruhet e shëndetëshmjia dhe e shëndoshi. Në terminologjinë e kësaj shkence *hadithi sahib* është hadithi që plotëson pesë kushte:

- 1- lidhja e senedit.
- 2- drejtësia e transmetuesit
- 3- përvetësimi i transmetuesit
- 4- mospasja e ndonjë ileti
- 5- mospasja e shudhudhit.

Nëse këto kushte përmbushen hadithi quhet sahih dhe argumentimi me të është i detyrueshëm.

### **14 Përcillet prej dabitit përvetësues ❀❀❀ i drejtë në fenë e tij çdo transmetues**

Këto janë dy kushtet e para që duhet të përmbushen në mënyrë që hadithi të konsiderohet *sahib*.

#### **Kushti i parë: Dabti (përvetësimi - الضَّبُّط).**

Çdo transmetues duhet të jetë *dabit* (ضابط) pra përvetësues i asaj që transmeton. Dabti apo përvetësimi është aftësia që zotëron transmetuesi për mësimin përmendsh, kujtesën, memorizimin dhe ruajtjen të paprekur të të transmetuarës. Kjo aftësi dallon nga një transmetues në tjetër. Përgjithësisht kemi dy lloje përvetësimesh:

1- **Përvetësim gjoksi.** Është ditja përmendsh dhe memorizimi i hadithit me riprodhimin e tij në kujtesë sa herë që i kërkohet.

2- **Përvetësim shënimi.** Është shkrimi dhe shënimi i haditheve nëpër fleta apo fletore. Shënimi duhet të jetë i kontrolluar, i rishikuar dhe i ruajtur që nga momenti i shënimit e gjer në momentin e transmetimit. Kushtëzohet që fletat apo librin të mos ia dorëzojë një të pabesueshmi i cili mund të ndryshojë apo të zëvendësojë në to.

**Kushti i dytë: Adaleti (drejtësia - العَدَالَةُ).**

Drejtësia është cilësia që gëzon transmetuesi, e cila e shtyn atë që t'i ruhet Allahut dhe t'i përmbahet normave të islamit dhe normave të mirësjelljes. Ruajtja (takvaja) është largimi nga fisku dhe harami, bashkë me praktikimin e detyrimeve fetare.

Dijetarët e hadithit i kanë kushtuar rëndësi të madhe drejtësisë së transmetuesit. Drejtësia e transmetuesit është kriteri bazë ku bazohet pranimi i hadithit. Përderisa kjo shkencë shqyrton vërtetësinë e fjalëve të profetit dhe të sahabëve vetëkuptohet që siguria në pranimin e haditheve duhet të jetë shumë e lartë.

Tabini i njohur Muhamed ibn Sirini *Allahu e mëshiroftë* ka thënë: “*Këto hadithe janë fe, prandaj vëreni nga e merrni fenë tuaj*”.<sup>7</sup>

Ibrahim Nehaiu *Allahu e mëshiroftë* ka thënë: “*Kur dëshironin të transmetonin prej një burri fillimisht vështronin namazin e tij, etikën e tij dhe pamjen e tij*”.<sup>8</sup>

**15 I lidhur pa shkëputje gjer në fund ❀❀❀ shudhudhi apo ilet nuk ka askund**

Këto janë tre kushtet e tjera të hadithit sahih.

**Kushti i tretë: Lidhja e senedit (ittisali - الأتصال)**

Lidhja e senedit nënkupton që çdo transmetues ta ketë marrë apo dëgjuar hadithin nga shejhu i tij, pra nga transmetuesi sipër tij dhe ky i dyti ta ketë marrë atë nga shejhu i tij e gjer në fund të zinxhirit të transmetimit.

Mënyrat e marrjes së hadithit nga shejhu janë të ndryshme. Mënyra kryesore është dëgjimi i senedit dhe i metnit të hadithit nga vetë goja e shejhut. Tjetër mënyrë e njohur është dëgjimi i hadithit nga lexuesi që lexon në prezencë të shejhut dhe me miratimin e tij. Mënyra të tjera janë edhe ixhazeja apo dorëzimi i librit. Të gjitha këto mënyra duhet të përmbushin kushte dhe kritere të caktuara që të jenë korrekte. Këto kushte dhe kritere sqarohen në libra më të zgjeruar.

**Kushti i katërt: Të mos jetë shadh.**

Shudhudhi është kundërshtimi që transmetuesi i besueshëm (thikat-it) i bën një transmetuesi më të besueshëm apo një grupi më të madh transmetuesish të cilët e meritojnë t'u jepet përparësi në pranimin e hadithit.

**Kushti i pestë: Të mos ketë ilet.**

*Ilet-i* në aspektin gjuhësor është sëmundja, kleçka apo ceni i diçkaje. Në aspektin terminologjik *ilet* quhen ato probleme dhe cene në hadith të cilat megjithëse në pamje të

---

<sup>7</sup> E transmeton Ibn Ebi Hatemi në “El xherhu uet tadil”.

<sup>8</sup> E transmeton Darimiu në Sunenin e tij, nr: 454 dhe Ibn Ebi Hatem në “El xherhu uet tadil”.

parë duken si jo evidente, ato janë evidente dhe hetohen nga dijetarët dhe kritikët e hadithit. Ato mund të evidentohen nga krahasimi i rivajeteve me njëri-tjetrin, nga rrethanat e ndryshme, apo dëshmitë e dijetarëve dhe të transmtuesve. Njohja e *ilet-ëve* është maja e kësaj shkence të cilën e arrijnë vetëm studiuesit e kualifikuar dhe dijetarët kritikues.

Nga këto dy kushte të fundit kuptojmë se për vlerësimin sahih të një hadithi nuk mjafton vetëm studimi dhe shqyrtimi i senedit, por duhet që ky shqyrtim të përfshijë edhe metnin. Tre kushtet e para lidhen vetëm me senedin, ndërsa kundërshtimet në kushtit e katërt dhe i pestë mund të ndodhin si në sened ashtu edhe në metën.

**16 I thënë më shkurt thikat pas thikati ❀❀❀ i pastër nga shudhudhi dhe ilati**

I përmbledhur më shkurt, përkufizimi i hadithit sahih mund të jetë: *“Hadithi i transmetuar thikat pas thikati që është i pastër nga shudhudhi dhe ilati”*. Thikat quhet transmetuesi i drejtë në fe dhe përvetësuesi i hadithit. Pra termi *thikat* përmban dy kushtet e para që janë drejtësia dhe përvetësimi. Ndërsa shprehja **(thikat pas thikati)** dëshmon për lidhjen e hadithit në zinxhir pa shkëputje. Fjala **(i pastër nga shudhudhi dhe ilati)** dëshmon për kushtin e katërt dhe të pestë që u sqaruan më sipër.

Shëmbull i hadithit sahih është hadithi që e transmeton Maliku në Muatën e tij, nga Ebu Zinadi, nga Arexhi, nga Ebu Hurejra se i dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: **“Çdo profet e ka pasur një lutje me të cilën lutej, ndërsa unë dëshiroj ta ruaj lutjen time si shefat për umetin tim në botën tjetër”**.

Ky hadith është sahih sepse senedi i tij është i lidhur pa shkëputje, të gjithë transmetuesit e tij janë thikatë dhe nuk është prekur nga ndonjë *ilet* apo shudhudh.

**17 Haseni çfarë na vjen në transmetim ❀❀❀ prej burrit të mangët në përvetësim**

Haseni është lloji i dytë i hadithit të pranuar. Që hadithi të vlerësohet për hasen duhet të plotësojë të njëjtat kushte si hadithi sahih. Dallimi mes tij dhe mes hadithit sahih qëndron vetëm në kushtin e përvetësimit të transmetuesit. Nëse për hadithin sahih kushtëzohet që të gjithë transmetuesit të kenë përvetësim të plotë, në hadithin hasen të paktën një transmetues nuk e arrin gradën e përvetësimit të plotë.

Hafidh Ibn Haxheri *“Allahu e mëshiroftë”* thotë: *“Ky hadith pajtohet me sahihun në pikën e argumentimit me të, megjithëse ai është në një gradë më të ulët se sahihu. Gjithashtu ngjason me sahihun në faktin se ai ka gradë të ndryshme ku disa janë më lart se disa të tjera”*.<sup>9</sup>

Shëmbull i hadithit hasen është hadithi që transmetohet nga Amr ibn Shuajbi, nga babai i tij, nga gjyshi i tij, se i dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: **“Shpagimi me dijet për muahidin është sa gjysma e shpagimit me dijet për të lirin”**.

---

<sup>9</sup> Nuz'hatun nadhar, fq: 105.

Dijetarët kanë mospajtime për hadithin e Amr ibn Shuajbit nga babai i tij nga gjyshi i tij. Mendimi më i favorizuar është mendimi se hadithet e Amr ibn Shuajbit nuk zbresin nga grada e hadithit hasen nëse nuk bien në kundërshtim me të tjerë apo nuk vërtetohet që ai ka gabuar.

Konkretisht hadithi i përmendur mësipërm është përforcuar edhe nga fetvaja e Uthmanit ؓ dhe fetvaja e disa fukahave të mëdhenj të Medines.

**Vërejtje:** Ka dallim mes termit “hadith sahih” dhe termit “sened sahih”. Imam Ebu Amr Ibn Salahu *Allahu e mëshiroftë* thotë:

*“Fjala e tyre “senedi i këtij hadithi është sahih” apo “senedi i tij është hasen” qëndron më poshtë fjalës së tyre ky është hadith sahih apo hadith hasen, sepse mund të thuhet që senedi i hadithit është sahih, mirëpo vetë hadithi nuk është sahih për shkak se mund të jetë shadh apo të përmbajë ndonjë ilet”.<sup>10</sup>*

**18 Çdo kusht haseni sa herë rrëzohet ؓؓؓ i dobët daif ky hadith gjykohet**

Hadithi daif është hadithi që nuk plotëson kushtet e të qenit hadith hasen. Ibn Salahu *Allahu e mëshiroftë*, pas përmendjes së kushteve të hadithit sahih dhe hasen thotë:

*“Çdo hadith që nuk plotëson kriteret e përmendura mësipër të hadithit sahih dhe të hadithit hasen, ai është hadith daif”.<sup>11</sup>*

Nisur nga fakti se problemet dhe shkaqet që çojnë në dobësinë e hadithit janë të lloj-llojshme, hadithi daif paraqet një larmi të gjerë llojesh dhe ndarjesh. Në vijim do të përmendim disa lloje kryesore të tij.

**19 Në rrugë të shumta nëse na përçohet ؓؓؓ në rang haseni edhe mund të ngrihet**

Në disa raste hadithi daif mund të ngrihet në rangun e hadithit hasen. Ngrihet në rangun e tij atëherë kur transmetohet nga rrugë të ndryshme të cilat përforcojnë njëra-tjetrën me kusht që dobësia e transmetuesit të mos jetë e theksuar dhe rrugët e tjera të vlejnjë për përforcim.

Fjala (**edhe mund të ngrihet**) tregon se jo përherë hadithi i dobët ngrihet në rangun e hadithit hasen dhe nuk është kusht që numri i shumtë i rrugëve të hadithit daif të dëshmojë për ngritjen e hadithit në rangun e hasenit. Në lidhje më këtë imam Neveviu *Allahu e mëshiroftë* shprehet:

---

<sup>10</sup> Mukadimetu Ibni Salah, fq: 38.

<sup>11</sup> Mukadimetu Ibni Salah, fq: 41.



*“Nëse hadithi trasmetohet nga rrugë të dobta, nuk është kusht që si rezultat i tyre hadithi të ngrihet në rangun e hasenit. Kjo ndodhë kur dobësia kthehet tek dobësia e përvetësimit të ravit saduk dhe të singertë (emin), atëherë kjo (dobësi) largohet kur hadithi vjen nga një rrugë tjetër dhe bëhet hasen”.<sup>12</sup>*

Shembull për këtë është hadithi që e transmeton Tirmidhiu nga rruga e Asim ibn Ubejdilahun, thotë: kam dëgjuar Abdullah ibn Amir ibn Rabian, nga babai i tij (Amir ibn Rabia) se një grua nga fisi fezara u martua për një palë këpucë dhe i dërguari i Allahut ﷺ i tha: A u kënaqe me një palë këpucë për veten dhe pasurinë tënde? I tha: Po. Thotë: Atëherë e aprovoi.<sup>13</sup>

Imam Trimidhiu thotë: *“Në këtë çështje ka transmetime nga Umeri, Ebu Hurejra, Sehl ibn Sadî, Ebu Saidi, Enesi, Aishja, Xhabiri dhe Ebu Hadrad Eslemiu. Hadithi i Amir ibn Rabias është hasen safih”.*

Sujuti në librin e tij “Tedribur ravi” thotë: *“Asimi është i dobët për shkak të memorizimit të dobët të tij. Tirmidhiu e ka konsideruar hasen këtë hadith të tij, për shkak se është transmetuar nga rrugë të tjera”.<sup>14</sup>*



---

<sup>12</sup> Et takrib i imam Neveviut, fq:

<sup>13</sup> E transmeton Trimidhiu në Sunenin e tij (1113).

<sup>14</sup> Tedrib er ravi, Xhelaludin Sujuti, botim i shtëpisë botuese “El-kitabul Arabi”, fq: 84.

## **Ndarja e hadithit në bazë të autorësisë**

### **20 Një tjetër ndarje në hadith bazohet ❀❀❀ në vartësi se kujt i adresohet**

Kjo ndarje e shqyrton hadithin në lidhje me autorësinë e shprehjes, veprimet apo aprovimit. Shprehjet dhe veprimet e ndryshme mund t'i adresohen profetit, sahabit apo tjetërkujt. Kjo ndarje nuk dëshmon vërtetësi apo pavërtetësi të hadithit. Termat e përdorur në këtë ndarje nuk shprehin saktësi apo dobësi të tij, por sqarojnë dhe përshkruajnë autorësinë e thënieve dhe të veprimeve.

Në vartësi se kujt i adresohet një hadith kemi tre lloje hadithesh:

- 1- Hadith merfu.
- 2- Hadith meukuf.
- 3- Hadith mektu.

### **21 Merfu thirret hadithi që përfundon ❀❀❀ në fjalë dhe vepra te profeti jonë**

#### **Hadithi merfu (i ngritur te profeti - المرفوع)**

Hadithi *merfu* është hadithi që dëshmon për një fjalë, vepër apo aprovim të profetit ﷺ. Termi merfu kthehet tek kuptimi i ngritjes dhe në aspektin gjuhësor dëshmon për të ngriturën apo të ngriturën. Është quajtur kështu sepse senedi ka dy anë:

- fillimin e senedit, i cili aludon muhadithin që transmeton hadithin
- përfundimin e senedit që aludon atë që i adresohet hadithi.

Muhadithi që transmeton hadithin qëndron në anën e poshtme dhe ai ngjitet transmetues pas transmetuesi derisa të arrijë te profeti ﷺ.

Hadithi mund të jetë merfu shprehimisht (merfu tasrihan) ose mund të jetë merfu në gjykim (merfu hukman).


Dijetarët ndajnë mendime të ndryshme për shprehje të sahabëve si “vepronim kështu në kohën e profetit”, “jemi urdhëruar kështu”, “jemi ndaluar prej kësaj”, “prej sunetit është kjo”, etj. Shprehje të tilla konsiderohen prej merfu’ut sipas shumicës së dijetarëve.

Shëmbull për hadithin merfu janë hadithet e mëposhtme:

*Mos më mbivlerësoni ashtu siç e mbivlerësuan të krishterët Isain të birin e Merjemes. Unë jam robi i tij prandaj thoni rob i Allahut dhe i dërguar i tij.*

*Semura ibn Xhundubi thotë: I dërguari i Allahut ﷺ kurr e falte ndonjë namaz kthhej me fytyrë nga ne.*

*Ebu Saidi thotë: Udhëtonim bashkë me të dërguarin e Allahut ﷺ në ramazan dhe agjëruesi nuk kritikohet për agjërimin dhe as mosagjëruesi për mosagjërimin.*



E ritheksojmë edhe një herë se përshkrimi i hadithit me termin *merfu* nuk nënkupton saktësimin apo vërtetimin e tij. Hadithi merfu mund të jetë sahih, hasen apo i dobët me të gjithë llojet e tij.

**22 Sa herë te sahabi senedi ndalon ❀❀❀ me termin meukuf ti e emërton**

**Hadithi meukuf (i ndalur tek sahabi - (المؤكوف -**




Kuptimi i termit *meukuf* kthehet tek kuptimi gjuhësor i kësaj fjale që është ndalja. U sqarua se muhadithi kur fillon tregimin e senedit ngjitet transmetues pas transmetuesi. Në rastin e meukufit senedi nuk ngjitet deri tek profeti ﷺ por ndalet tek sahabi. Për këtë shkak dijetarët e kanë emërtuar me termin *meukuf*.

Kështu, në aspektin terminologjik, meukufi mund të përkufizohet si hadithi që tregon një shprehje apo një vepër sahabi. Pra në këtë rast shprehja është e vetë sahabiut dhe jo e profetit ﷺ.

*Në këmi që në popull më i nënçmuar dhe Allahu na kënoi me islamit, prandaj sado që ta kërkojmë kënarinë me atë që Allahu nuk na kë kënuar, Allahu kë për të na poshtëruar.*

*Nafiu tregon se: Abdullah ibn Umeri lahej në ditën e fitërbajramit përpara se të dilte për në musallë.*

*Nafiu thotë: Abdullah ibn Umeri i shikonte banorët buzë ujit mes Mekës dhe Medines, ta falnin xhumanë dhe nuk i këtikonte.*



**23 Quaj mektu çdo vepër a shprehje ❀❀❀ te një tabiin nëse gjen prehje**

**Hadithi mektu (i ndërprerë tek tabini - المَطَّوْع )**

Termi mektu kthehet tek kuptimi i gjuhësor i këputjes dhe i ndërprerjes. Në dy llojet e mëparëshme u përmend se muhadithi ngjitet në transmetim shtresë pas shtrese dhe kur hadithi ndërpritet në shtresën e tabinit pa u ngjitur më lart ai quhet mektu. Fjala (**gjen prehje**) ndalet tek tabini dhe nuk ngjitet në një shtresë më të lartë.

Pra mektu janë fjalët dhe veprat e tabiinëve apo të dijetarëve pas tyre. Hadithi mektu \_njësjo\_ si dy llojet e mëparëshme\_ mund të jetë i pranuar ose i refuzuar, sahih apo daif.



## **Terma rreth lidhjes dhe shkëputjes**

### **24 Senedi muttesil-it ngjan si gjerdan ❀❀❀ i lidhur shejhi për shejhi vjen si vargan**

#### **Hadithi muttesil (i lidhur - المتصل)**

*Muttesil* konsiderohet çdo hadith që senedin e tij e ka të lidhur transmetues pas transmetuesi. Me të njëjtin kuptim \_por më rrallë\_ përdoret edhe termi *meusul*.

Përshkrimi i hadithit si muttesil lidhet vetëm me përshkrimin e senedit, pavarisht kujt i adresohet hadithi. Imam Neveviu *Allahu e mëshiroftë* thotë:

*“Muttesili, që quhet ndryshe edhe meusul, është ai që senedin e ka të lidhur, qoftë ai merfu apo i ndalur (meukuf) te kushido qoftë”.*<sup>15</sup>

### **25 Merfu-i muttesil i lidhur në sened ❀❀❀ sipas xhumhurit njihet për musned**

#### **Hadithi musned (المسند)**

Termi *musned* është përdorur me kuptime të ndryshme në mesin e dijetarëve të hadithit. Kuptimi më i përhapur dhe më i hasur në mesin e tyre është ky që kemi pohuar në këtë varg. Pra ai është hadithi i lidhur (muttesil) i cili përfundon tek i dërguari i Allahut ﷺ (hadithi merfu). Sipas këtij përkufizimi nga termi musned mbeten jashtë hadithe si meukufi, mektui, murseli, munkatui, mudeli dhe mudellesi.

Hatib Bagdadiu e përgjithëson më tepër termin *musned* dhe përcjell se dijetarët e hadithit e përdorin këtë term për çdo hadith që senedin e ka të lidhur deri në cakun e tij por thekson se dijetarët zakonisht e përdorin për hadithin merfu.<sup>16</sup>

Bazuar në përkufizimin e Hatib Bagdadiut *Allahu e mëshiroftë* musnedi i bie të jetë sinonim i muttesil-it, pavarisht se Hatibi e pranon se ai zakonisht përdoret më shumë për muttesilin merfu.

Ibn Abdulberri *Allahu e mëshiroftë* jep një mendim tjetër. Ai pretendon se musned quhet çdo hadith që përfundon tek profeti ﷺ, i lidhur apo i shkëputur qoftë. Ky mendim është kundërshtuar nga shumica e dijetarëve dhe nuk haset shumë në përdorimin e tyre.

---

<sup>15</sup> Et takrib, fq:

<sup>16</sup> Shiko El mukaddimeh dhe Et takrib,

## **Disa lloje të shkëputjes**

Në sqarimin e kushteve të hadithit sahih treguam që senedi i hadithit duhet të jetë i lidhur dhe pa shkëputje. Mospërmbushja e këtij kushti çon në dobësimin e hadithit. Përgjithësisht shkëputja konsiderohet si ilet ndikues (illetun kaduha) në sened dhe ndikon direkt në vlerësimin e gradës së hadithit.

Shkëputja njihet nëpërmjet njohjes së historikut të transmetueseve, datës së lindjes, datës së vdekjes apo kërkimit të dijes. Ajo njihet gjithashtu nga ballafaqimi i rivajeteve dhe rrugëve të ndryshme të hadithit. Shkëputja si dukuri e senedit është e larmishme dhe shfaqet në forma dhe në gradë të ndryshme. Shpeshherë ajo mund të jetë e hetueshme lehtësisht dhe herë të tjera mund të jetë e fshehtë dhe e maskuar. Këtu do të paraqesim vetëm tre lloje kryesore të shkëputjes në sened që janë

- 1- irsali dhe hadithi mursel
- 2- inkitau dhe hadithi munkati
- 3- tedlisi dhe hadithi mudelles

**26 Fjalët e profetit që tabini sjell ❀❀❀ ai s'i ka dëgjuar prandaj janë mursel**

### **Hadithi mursel (المُرْسَل)**

Hadithi mursel është hadithi që tabini e përmend nga profeti ﷺ pa cituar se prej kujt e ka marrë këtë hadith. Tabini nuk ka arritur të dëgjojë prej profetit ﷺ dhe padyshim që mes tij dhe profetit duhet të ketë transmetues të tjerë. Problemi i hadithit mursel qëndron në faktin se ekziston mundësia që mes tabinit dhe profetit të ketë persona të tjerë veç sahabëve të cilët mund të jenë të dobët apo të panjohur. Përderisa kjo mundësi është e evidente atëherë hadithi mursel nuk paraqet, sipas dijetarëve të hadithit, siguri të lartë.

*Irsal-i* në gjuhën arabe tregon lëshim dhe është e kundërta e *isnad-it* që tregon mbështetje. Është quajtur kështu sepse tabini e hedh dhe e lëshon fjalën te profeti ﷺ pa përmendur tek kush është mbështetur në përcjelljen e saj.

Sipas dijetarëve të hadithit hadithi mursel është një lloj i hadithit daif për shkak të shkëputjes së tij. Megjithatë ai mund të përforcohet në disa raste dhe mund të shërbejë për argumentim në raste të caktuara me kushte dhe kritere, për të cilat dijetarët kanë mospajtime.

Shembull për hadithin mursel është hadithi që transmeton Maliku nga Zejd ibn Eslemi, nga Ata ibn Jesari se i dërguari i Allahut ﷻ ka thënë: **“O Allah! Mos e bëj varrin tim put që adhurohet. Zemërimi i Allahut është shtuar mbi atë popull që i marrin varret e profetëve të tyre për vendfalje”**.

Versioni i hadithit i transmetuar nga Maliku në Muatën e tij është mursel sepse Ata

ibn Jesari nuk e ka arritur të dërguarin e Allahut dhe nuk ka dëgjuar prej tij.<sup>17</sup>

**27 Shkëputja munkatiut kuptohet fare lehtë ❀❀❀ pasi mes dy vetëve mungon një i tretë**

**Hadithi munkati**

*Inkitau* në aspektin gjuhësor është shkëputja. Në terminologjinë e hadithit përdoret zakonisht për një lloj të caktuar shkëputje, që është shkëputja e hetuar mes dy transmetuesve duke përjashtuar kështu murselin që pëson shkëputje mes tabinit dhe profetit.

Nëse në mes të dy transmetuesve vlerësohet se mungojnë dy transmetues, kësaj lloj shkëputje i jepet një emërtim më specifik dhe quhet model (مُعْضَل). Shpeshherë dijetarët mjaftohen me termin munkati qoftë kjo shkëputje e vlersuar me mungimin e një apo dy transmetuesve, sepse rëndësi ka që zinxhiri i transmetuesve është i shkëputur.

Shëmbull për hadithin munkati është hadithi që e transmeton Ebu Daudi në Sunenin e tij nga rruga e Junus ibn Jezidit, nga Ibn Shihabi se Umer ibn Hatabi ka thënë mbi minber: **“O njerëz! Mendimi i pagabushëm ka qënë prej të dërguarit të Allahut ﷺ, ngase Allahu ia shfaqete (të vërtetën), ndërsa prej nesh është vetëm hamendësia dhe tekellufi”**.

Imam Mundhiri *Allahu e mëshiroftë* thotë: “Ky hadith është munkati. Zuhriu (pra Ibn Shihabi) nuk e ka arritur Umerin”.

Duhet të theksojmë se disa dijetarë e përdorin termin munkati për çdo lloj shkëputje, qoftë ajo mes tabinit dhe profetit ﷺ apo në brezat pas tabinëve dhe në këtë rast termi munkati është më i gjerë dhe përfshin edhe murselin. Megjithatë zakonisht termi munkati përdoret për shkëputjen që ndodh në brezat pas tabinit dhe Allahu është më i ditur.

**28 Fshehje të shejhut bën mudel-lisi ❀❀❀ me “prej” apo “nga” që është tedlisi**

**Tedlisi dhe hadithi mudel-les.**

Tedlisi është një lloj shkëputje e fshehtë dhe e jo lehtësisht e hetueshme. Në aspektin gjuhësor, tedlisi kthehet tek fjala *deles* që është përzierja e territ të natës me dritën e ditës. Vetë tedlisi është fshehja dhe mbulimi i një të mete.

Në terminologjinë e hadithit tedlisi është fshehja që transmetuesi i bën shejhut të tij duke e transmetuar hadithin nga shejhu i shejhut të tij \_i cili njëkohësisht është edhe shejhu i transmetuesit\_ nëpërmjet mbulimit të tij me shprehje të diskutueshme si “nga” apo “prej”.

---

<sup>17</sup> Maliku e transmeton këtë hadith mursel. Pjesa e parë e hadithit “mos e bëj varrin tim put që adhurohet” transmetohet i lidhur (musned) nga Said Hudari rah. Atë e ka saktësuar Ibn Abdulberri në Et temhid. Kjo pjesë transmetohet edhe prej Ebu Hurejras rah. Imam Ahmedi e transmeton në musnedin e tij (7358) prej Ebu Hurejrës rah. se i dërguari i Allahut rah. ka thënë: **“O Allah! Mos e bëj varrin tim put. Allahu i mallkoftë ata njerëz që i marrin varret për vendfalje”**. Muhadithi Ahmed Shakir thotë: “Senedi i tij është i fortë”. Pjesa e dytë e hadithit “Zemërimi i Allahut është shtuar ...” është e njohur dhe e transemtuar me rrugë të ndryshme sahihe se Allahu i ka mallkuar çifutët dhe të krishterët të cilët i kanë shndërruar varret e profetëve të tyre në vendfalje.

Që të sqarohet më mirë po paraqesim këtë shëmbull. Imam Hakimi transmeton në librin e tij “Marifetul ulumil hadith” me sendin e tij deri tek Ali ibn Hashremi thotë: *“Ibn Ujejna na tha: Nga Zuhriu. I thanë: A e ke dëgjuar prej Zuhriut? Na tha: Jo, madje as nga ai që ka dëgjuar Zuhriun. Na ka treguar Abdurrezaku na Mameri nga Zuhriu”*.

Në këtë sened Sufjan ibn Ujejna fillimisht fshehu dy vetë mes tij dhe mes imam Zuhriut, duke ditur që Sufjan ibn Ujejna ka qënë nxënës i imam Zuhriut dhe ka dëgjuar shumë hadithe prej tij. Rrëzimi i dy vetave mes tij dhe mes Zuhriut dhe përdorimi i fjalës “nga” apo “prej” i krijon përshtypjen dëgjuesit se Sufjani e ka dëgjuar këtë hadith prej Zuhriut, ndërkohë që në realitet nuk është kështu.

Tedlisi i Sufjanit në këtë rast ishte nga dy thikatë (të besueshëm). Problemi i tedlisit qëndron te mundësia e përdorimit të tij prej transmetuesit si mjet për fshehjen e një shejhu të dobët, të cilin nuk e përmend por përmend shejhun pas tij që njëkohësisht është edhe shejhu i transmetuesit me tedlis. Ky mbulim të jep përshtypjen se transmetuesi e ka dëgjuar këtë hadith direkt nga ky shejh i dytë. Ky maskim në sened të shtyn në konsiderimin e hadithit për hasen apo sahih ndërkohë që ai nuk është i tillë, sepse mes tyre ekziston një transmetues i dobët i maskuar nga vepruesi i tedlisit.

Disa dijetarë i kanë bërë xherh vepruesit të tedlisit (mudell-lisit) dhe i kanë rrëzuar transmetimet e tij tërësisht. Më i njohuri prej tyre ka qënë Shube ibn Haxhaxhi, prej të cilit transmetohet të ketë thënë: “Tedlisi është simotra e gënjeshtër”. Gjithashtu ka thënë: “Preferoj më shumë të bie prej qiellit sesa të bëj tedlis”.

Nuk ka dyshim se tedlisi është një veprim i urryer dhe i papëlqyer, sepse fshehja e një transmetuesi krijon mjegull dhe çoroditje në senedin e hadithit. Urrejtja e tij është transmetuar nga shumë imamë, si puna e Ibn Mubarekut, Vekiut, Hamad ibn Zejdit dhe të tjerë.

Megjithatë dijetarët nuk e kanë rrëzuar besueshmërinë e praktikuesit të tedlisit. Pavarsisht se mudellisi (praktikuesi i tedlisit) fsheh diçka mirëpo ai nuk arrin deri te gënjeshtera apo mashtrimi haptas. Shprehje si “nga” apo “prej” nuk tregojnë shprehimisht që transmetuesi e ka dëgjuar këtë hadith nga ky shejh por mund të dëshmojnë edhe se hadithi transmetohet nga rruga e tij dhe rrjedhimisht nuk vërtetohet gënjeshtera apo mashtrimi haptas.

Nisur nga fakti se në mesin e praktikuesve të tedlisit ka shumë transmetues të njohur për rivajetet e të cilëve kemi nevojë, dijetarët janë të treguar të kujdesshëm dhe të matur në pranimin dhe refuzimin e rivajeteve të tyre. Ata nuk i kanë refuzuar totalisht rivajetet e tyre dhe as nuk i kanë pranuar tërësisht. Kur mudellisi (praktikuesi i tedlisit) transmeton me shprehje që shprehin dëgjim të drejtëpërdrejtë të hadithit si “kam dëgjuar” apo “më ka treguar”, transmetimi i tij pranohet dhe konsiderohet i lidhur. Por nëse mudellisi transmeton me shprehje të dyshimta si “prej, nga, ka thënë” atëherë ky transmetim i tij nuk pranohet dhe konsiderohet i shkëputur dhe i dobët, për shkak të mosigurisë që paraqet në fshehjen dhe mbulimin e transmetuesit.

Ky që përmendëm quhet tedlis i isnadit dhe është lloji më i përhapur dhe më i njohur i tedlisit. Kemi edhe lloje të tjera të tedlisit, si tedlisi i tesvijes apo tedlisi i shejhëve apo lloje më të ralla të cilat trajtohen më gjerë në libra më të avancuar.





## **Tipe të tjerë të hadithit daif**

29 *Mes dy thikatëve kur ka kundërshtim* ❀❀❀ *deri aty sa s'mund të ketë pajtim*

30 *Mahfudhi më i fortë ka përparësi* ❀❀❀ *shadhî kundërshtues tregon dobësi*

### **Hadithi shadh dhe mahfudh.**

Kur dy hadithe \_në pamje të parë\_ bien në kundërshtim me njëri-tjetrin atëherë duhen interpretuar në atë mënyrë që të dy ato të përputhen me njëri-tjetrin, sepse pajtimi mes dy argumenteve është më parësor sesa rrëzimi i njërit prej tyre. Kundërshtimi në këtë rast nuk është real, por është vetëm një supozim paraprak që largohet me përputhjen korrekte mes dy haditheve.

Nëse pajtimi mes tyre është i vështirë apo i pamundur, atëherë shqyrtohet mundësia e abrogimit (naskhit) të njërit prej tyre. Nëse nuk na bëhet i qartë as abroguesi me të abroguarin atëherë kundërshtimi është real dhe duhet pajtjetër t'i jepet përparësi njërit prej tyre. Kështu hadithin më të fortë e pranojmë për sahih dhe në këtë rast quhet **hadith mahfudh**, ndërsa hadithin që kundërshton mahfudhin e konsiderojmë të dobët dhe e quajmë **hadith shadh**.

Duke qënë se të dy hadithet vijnë nga rruga e thikatëve, përparësia nuk mund të bazohet vetëm në faktin se dikush është thikah (i besueshëm). Dhënia përparësi mund të bazohet tek disa kriteret, ku prej tyre mund të përmendim:

- 1- Besueshmëria më e lartë e njërit transmetues ndaj tjetrit.
- 2- rrugët e shumta të transmetimit.

Kundërshtimet mes thikatëve mund të ndodhin si në metne ashtu edhe në senede, madje mund të thuhet se kundërshtimet në senede janë më të shpeshta dhe më evidente.

31 *Lëkundjet mospajtuese janë idtirab* ❀❀❀ *hadithi me përplasje quhet mudterib*

### **Hadithi mudterib.**

Kur përplasjet dhe mospajtimet janë të shumta dhe të forta sa nuk mund t'i japim përparësi asnjërit hadith, ky hadith quhet mudterib dhe konsiderohet daif.

32 *Daifi e thikati kur bien ndesh* ❀❀❀ *marufin e të dytit merre parasysh*

33 *Munkerin daifit kurrë mos ja prano* ❀❀❀ *gabimin e tij patjetër refuzo*

#### **Hadithi munker dhe maruf (المُنْكَرُ وَالْمَعْرُوفُ).**

Nëse kundërshtimi ndodh mes një transmetuesi thikat dhe mes një transmetuesi daif (të dobët) atëherë hadithi i transmetuesit të besueshëm quhet **hadith maruf** ndërsa hadithi i transmetuesit të dobët quhet **hadith munker**.

Ashtu si edhe në rastin e mësipërm përplasjet mes thikatit dhe daifit mund të ndodhin në metën dhe në sened dhe në këtë rast i jepet përparësi hadithit të thikatit kurdoherë.

34 *Hadithi meudu çfarë është sajuar* ❀❀❀ *nga një gënjeshtar ai është trilluar*

#### **Hadithi meudu (i shpikur - المَوْضُوع -)**

Hadithi meudu është hadithi i shpikur dhe i trilluar. Ky është lloji më i keq i hadithit daif. Transmetimi i një hadithi të tillë ndalohet kategorisht në çfarëdo rasti apo teme, përveç nëse me transmetimin e tij kihet për qëllim sqarimi i shpikjes së tij. Hadithi meudu njihet nëpërmjet fakteve dhe mënyrave të ndryshme, prej tyre mund të përmendim:

- pohimi i vetë transmetuesit për trillimin apo përfitim i këtij pohimi tërthorazi.
- rrethana që lidhen me ravin si vërtetimi se ai është gënjeshtar dhe trillues.
- rrethana dhe dëshmi që lidhen me vetë të transmetuarën (metnin).

Trilluesit e hadithit janë të shumëllojtë. Disa pasues të sektit kerami e kanë lejuar vendosjen e haditheve që flasin për nxitjen e njerëzve për mirësi dhe pengimin e tyre prej të keqes. Padyshim kjo është kundërvënie ndaj ixhmasë së muslimanëve për mostrillimin e haditheve.

Hadithe kanë shpikur edhe zindikët, por këto hadithe të shpikura i kanë nxjerrë në pah kolosët e kësaj shkence.

Ndonjëherë personi mund të bjerë në sajimin e hadithit pa dashje, për shkak të harresës dhe ngatërrimit të shpeshtë të tij, duke i mveshur profetit ❀ fjalë të personave të tjerë.



## **Çështje rreth xherhit dhe tadilit**

U shpjegua se vërtetimi i metnit të hadithit lidhet drejtpërsëdrejti me vërtetimin e senedit, pra me përmbushjen e kushteve që zinxhiri i transmetuesve duhet të plotësojë për të qënë i pranuar. Që të bëhet e mundur dalja në konkluzione sa më të drejta, lind si nevojë shqyrtimi i të gjithë transmetuesve të haditheve një nga një.

Si rezultat i kërkimeve, shqyrtimeve dhe analizimeve të dijetarëve rreth transmetuesve të hadithit ka lindur kjo disiplinë e shkencës së hadithit që njihet me emrin “el xherhu uet tadil”.

Të folurit rreth transmetuesve të hadithit me xherh apo tadil nuk hyn tek përgojimi apo përfolja e ndaluar, por hyn tek dëshmia dhe gjykimi ndaj tyre sipas normave shariatike dhe vetëm nëpërmjet saj arrihet shqyrtimi dhe kritika e shëndoshë e haditheve profetike.

Transmetohet se Ebu Bekër ibn Haladi i tha Jahja ibn Said Kattaniut: A nuk druhash se këta të cilëve ua ke lënë hadithin do të jenë hasmit e tu ditën e gjykimit? Jahja i tha: “*Që të jenë ata hasmit e mi është më mirë sesa të jetë hasmi im i dërguari i Allahut ﷺ dhe të më thotë: Përse nuk e ke larguar gënjeshtren prej fjalëve të mia?!.*”

Një asket sufi iu drejtua Abdullah ibn Mubarekut me fjalët: A po përgojoke?! Ibn Mubareku ia ktheu: “*Rri rehat! Si do ta shquanim të vërtetën prej të kotës sikur të mos sqaronim?!.*”

Kjo disiplinë është një nga disiplinat më të gjera dhe më të vështira dhe konsiderohet disiplinë kyçe në dijen e hadithit. Të paktë janë ata që mund të flasin me kompetencë në këtë disiplinë. Më poshtë dëshirojmë t’i paraqesim lexuesit vetëm disa terma elementarë dhe në vija të trasha, pa hyrë në detaje të hollësishme.

### **35 Për tadil vlerësohet çdo kompliment ❀❀❀ në adresë të ravit e bën një kompetent**

Tadili është vlerësimi i transmetuesit (ravit) me cilësinë e drejtësisë (adaletit) dhe të përvetësimit. Ibn Kethiri *\_Allahu e mëshiroftë\_* thotë:

*“Adaleti i ravit vërtetohet me mirënjohjen e tij për mirësi dhe komplimentat e mira ndaj tij ose me vlerësimin me adalet prej imamëve, apo prej dy prej tyre apo qoftë edhe prej një të vetmi sipas mendimit më të saktë, qoftë edhe nëpërmjet një rivajeti të vetëm, sipas një mendimi”.<sup>18</sup>*

---

<sup>18</sup> Ihtiasar ulumul hadith, Shtëpia Botuese El-meraif, kontrollim dhe komentim i Ahmed Shakirit, fq: 86.

Transmetuesit e mirënjohur në mesin e dijetarëve të hadithit e përfitojnë vërtetimin e adaletit nga vetë njohja, pranimi dhe reputacioni që ata gëzojnë në mesin e dijetarëve, si puna e imam Ahmedit, Shafiut, Malikut, Shubes, Theruriut, Ibn Ujejnës, Ibn Mubarekut, Euzaiut, Jahaja ibn Mainit, Ibn Medinit, etj.

Për pranimin dhe vlerësimin me adalet të transmetuesve të tjerë lipset dëshmia e imamëve kompetentë për xherhin dhe tadilin. Kjo dëshmi përmbushet me komplimentat dhe lëvdatat që ravi (transmetuesi) i merr qoftë edhe prej një dijetari kompetent të vetëm, sipas mendimit më të saktë.

**36 Thikati i besueshëm në transmetim ❀❀❀ saduku më pak por vlen për pranim**

Përgjithësisht transmetuesi i pranueshëm duhet të plotësojë disa kushte, të cilat Ibn Kethiri i përmbledh me këto fjalë:

*“I pranuari është ai thikat përvetësues (dabit) i asaj që transmeton dhe ai është muslimani me zhvillim mendor, madhor, i pastër nga shkaqet që të çojnë në fisk apo cenojnë edukatën. Ai duhet të jetë i vëmendshëm dhe jo gafil, memorizues nëse tregon prej memories së tij, njohës nëse transmeton me kuptim. Nëse një nga këto kushte bie atëherë transmetimi i tij refuzohet”.<sup>19</sup>*

Transmetuesit e pranueshëm kanë grada të ndryshme. Grada më e lartë e tij është grada e thikatit. Vetë kjo gradë ka një diapazon të gjerë. Maja e saj janë terma si imam, hafidh, thikah thebt, thikah thikah dhe në shumicën e rasteve përdoret vetëm thikah.

Në esencë thikat është ai transmetues me gradë përvetësimi të fortë dhe përpikëri të lartë në transmetim.

Kur kjo përpikëri në transmetim dhe kjo gradë në përvetësim bie në një nivel më të ulët, por duke vazhduar të ruhet, transmetuesi në këtë rast quhet saduk. Saduku nuk ka një gradë të lartë përvetësimi dhe qëllon që gabon shpesh herë. Megjithatë hadithi i tij nuk bie poshtë tërësisht por në anën tjetër nuk është i fortë si hadithi i thikatit. Transmetimi i tij mund të arrijë gradën e hasenit nëse nuk bie në kundërshtim me transmetime të tjera dhe sigurohemi se ai nuk ka gabuar.

**37 Ravin e rrëzon xherhi i shitjelluar ❀❀❀ cenet ja shfaq kritika e qëlluar**

Pranimin e ravit \_që është transmetuesi\_ e rrëzon xherhi nga një kompetent dhe njohës i shkaqeve të xherhit. Nëse për një transmetues të caktuar përplasen bashkë xherhi

---

<sup>19</sup> Ihtisar ulumil hadith, fq: 86.

me tadilin atëherë përparësi i jepet xherhit të shtjelluar.

Për njohjen e problemeve dhe të mangësive që paraqet një trasmetues i caktuar lypet njohje e thellë dhe eksperiencë e gjerë në lidhje me rivajetet dhe trasmetuesit. Gjykimi për dobësinë apo rrëzimin e një trasmetuesi nuk kthehet tek epsi apo supozimet, por tek ballafaqimi i rivajeteve të tij me rivajetet e trasmetuesve të tjerë dhe kundërshtimi i trasmetimeve të tij në vetvete apo në lidhje me trasmetuesit e tjerë. Sa më të shumta të jenë gabimet dhe kundërshtimet e një trasmetuesi aq më i dobët dhe i pa sigurtë është ai.

Dobësia e trasmetuesit nuk ka një gradë të vetme. Dobësia e disa trasmetuesve nuk është e madhe. Megjithëse ata janë të dobët në vetvete dhe hadithi i tyre nuk pranohet nëse veçohen, mirëpo ata \_në raste të caktuara\_ vlejnë si dëshmues dhe përforcues të ndonjë trasmetuesi tjetër. Trasmetues të tillë nuk janë kritikuar dhe dobësuar për shkak të drejtësisë së tyre, por vetëm për memorizimin e dobët dhe për ngatërrimin e shpeshtë.

Në disa raste memorizimi i dobët mund të arrijë grada më të theksuara dobësie, aq sa trasmetuesi i dobët në këtë rast nuk vlen as për dëshmi dhe përforcime.

Në raste të tjera trasmetuesi mund të kritikohet dhe të dobësohet për shkak të humbjes së drejtësisë së tij, si në rastin e fasikut, apo për shkak se është akuzuar për trillime. Në raste të tilla ai rrëzohet tërësisht dhe nuk mund të shërbejë si argument në asnjë formë.

### **38 Bazuar te fisku bidati sajesa ❀❀❀ gabimi gafleti si dhe ngatërresa**

#### **Shkaqet e dobësimit të trasmetuesit (ravit).**

Shkaqet e vlerësimit me dobësi të trasmetuesit janë të shumta, ku nga më kryesoret janë:

1- Fisku. Fasikut nuk i pranohet dëshmia dhe rrjedhimisht nuk i pranohet as trasmetimi i hadithit në çfarëdo forme qoftë ai.

2- Bidati. Bidatet ndahen në dy lloje, bidate që janë kufër dhe bidate që nuk e arrijnë gradën e kufrit. Ata që bien në kufër për shkak të këtyre bidateve u bie drejtësia dhe nuk u pranohen trasmetimet. Ndërsa për ata që justifikohen me keqinterpretim apo veprojnë bidateve që nuk janë kufër, janë dhënë shumë mendime prej dijetarëve. Disa e refuzojnë kategorisht pranimin e tyre. Të tjerë e kanë pranuar trasmetimin e tyre me kushte. Mbase mendimi më i saktë është pranimi i trasmetimeve të tyre me këto kushte:

- të mos jetë prej thirrësve në bidat.
- të mos jetë trasmetim që lidhet me bidatin e tij.

Këto kushte që vendosen për bidatçiun janë kushte shtesë, pasi të jenë plotësuar kushtet e tjera të drejtësisë, devotshmërisë dhe përvetësimit të hadithit.

3- Sajesa që është trillimi dhe gënjeshtria në hadithe. Nëse gënjeshtria vërtetohet atëherë një trasmetuesi të tillë nuk i pranohet asnjë trasmetim.

4- Gabimi. Gabimi në hadith është shenjë e memorizimit të dobët. Transmetuesi që gabon shpesh nuk është i sigurtë në transmetimet e tij dhe prandaj dobësohet.

5- Gafleti. Nëse gabimet shtohen deri aty sa transmetuesi nuk bën dallim mes transmetimeve të tij dhe transmetimeve të tjerëve për shkak të dobësisë së theksuar në memorizim, atëherë ai quhet mugaffel dhe hadithi i tij është shumë i dobët.

6- Ngatërresa. Me ngatërresën këtu kemi për qëllim përzjerjen që transmetuesi i bën hadithit në sened dhe metën dhe njihet me termin ihtilat.

**39** *Mexhfululu ajni kush është nuk njihet* ❀❀❀ *mexhfulu halit gjëndja nuk i dihet*

7- Nga shkaqet e refuzimit të transmetuesit dhe transmetimit është mosnjohja e transmetuesit, që njihet me termin *xhehalet*. Xhehaleti mund të ndahet në tre lloje:

a- Xhehaleti i ajnit. Bëhet fjalë për mosnjohjen e vetë transmetuesit. Transmetuesi mexhfulul ajn është transmetuesi të cilët edhe pse i është përmendur emri, mirëpo ai nuk njihet sepse prej tij transmeton vetëm një person i vetëm.

b- Xhehaleti i halit (gjendjes). Nga ky transmetues transmetojnë dy ose më tepër persona dhe njihet kush është si person, mirëpo për shkak të numrit të pakët të transmetimeve dhe të transmetuesve prej tij, nuk është krijuar mundësia për dhënien e një gjykimi në lidhje me xherhin apo tadilin e tij.

c- Ibhami dhe transmetuesi në këtë rast quhet mubhem. Ai është transmetuesi të cilit nuk i është përmendur emri, si psh. në rastin kur thuhet transmeton një burrë, apo një person apo dikush, pa ia përmendur emrin. Ibhami është një lloj xhehaleti i ajnit (personit) sepse transmetuesi mubhem nuk dihet se kush është njësoj si mexhhu ajni.

**40** *Zotit tim bujar në fund i kërkoj* ❀❀❀ *në rrugën e tij të na udhëzojë*

**41** *Me hamd'in e tij po e përfundoj* ❀❀❀ *me pikën e vesës po e titulloj*

